



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

KESHILLI I BASHKISE I QYTETIT KORÇE

VENDIM

Nr. 97 Date 18.10.2010

DHENIE E KREDISE SE LEHTESUAR NGA SHTETI PER FAMILJET QE PERFITOJNE BANESA SOCIALE ME KOSTO TE ULET,NE ZBATIM TE UDHEZIMIT TE K.M., NR.6257,DATE 02.09.2008.

Keshilli i bashkise i qytetit Korçe,ne mbledhjen e tij te dates se sotme,pasi analizoi relacionin e paraqitur nga komisioni i strehimit "Mbi dhenien e kredise se lehtesuar nga shteti per familjet qe perfitojne banesa sociale me kosto te ulet",ne zbatim te Udhezimit te K.M. nr.6257,date 02.09.2008, mbeshtetur ne ligjin nr.8652,date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore",ne ligjin 9232,date 13.05.2004 "Per programet sociale per strehimin e banoreve ne zonat urbane,i ndryshuar, Vendimit te K.M.nr.53,date 28.01.2005 "Per percaktimin e dokumentacionit te nevojshem,afateve dhe procedurave per te perfituruar strehim nga programet e banesave sociale me qera",Vendimit te K.M.nr.814,date 03.12.2004,"Per normat e strehimit per familjet qe perfitojne nga programet sociale te strehimit",Udhezimit te KM.nr.6257,date 02.09.2008,"Per percaktimin e mases se subvencionit per familjet qe perfitojne kredi te lehtesuara nga shteti",Vendimit te Keshillit te Bashkise nr.101,date 26.11.2007,"Per miratimin e sistemit te pikezimit per banesat sociale me kosto te ulet", mbeshtetur ne kopetencat qe ka si dhe pas diskutimeve te antareve

Vendosi :

1.Te miratoje listen e shtate te aplikanteve fitues per kredi te lehtesuara nga shteti.

2.Nq.se do te kete aplikante qe nuk do te perzgjidhen nga banka per te perfituar nga kredi,ata do te vazhdojne te qendrojne ne listen pritesese per tu trajtuar me banese sociale sipas kritereve qe percakton ligji 9232,date 13.05.2004”Per programet sociale per strehimin e banoreve ne zonat urbane”

3.Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet sektori i strehimit prane drejtorise se perkrahjes sociale dhe strehimit.

4.Ky vendim hyn ne fuqi dhjete dite pas shpalljes.

KRYETARI
Gjergji PENDAVINJI



Dixhitalizuar nga www.infocip.org